

DIGNIS QIRIXIDHI



Devonjat

WUERSCHA

891.P83-1

2 66

S

DIONIS QIRIXIDHI

BURONJAT

vjersha

56216

30308



Tirazhi 2500 kopej Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1971

NË TIRANË NIS AGIMI

Kur sheshi «Skënderbe» boshatiset nga njerëzit dhe
veturat,
te shtypshkronja «Zëri i Popullit»
rrjeshtohen gazet «Karpate» të gazetave,
gërshetohet dhe përqafohet
në lindjen e çdo dite
mirëmëngjezi i ngrohtë i shoferëve që zgjatet te
boritë
me zhurmat e metalta të shtypshkronjës.
Janë mbledhur bashkë
blegërimat e qengjave, sirenat e trenave dhe të
uzinave,
dhe ashtu tufë futen
në kolonat e gazetave.
Gjithë tingujt e atdheut në këtë shtypshkronjë.

Vajza me flockë kaçurrela dhe sy të trandafilta
paketon e lidh gazetat,
fshatrat dhe qytetet shkruan mbi etiketa.

Nga ky shesh i vogël, i zakonshëm,
kur nis agimi rozë,
shpërndahen si rrezet
Gazet, «Karpate» ngarkuar me gazeta.
Ushqejnë, si gjaku, çdo qelizë,
me fjalën e ngrohtë të partisë.

Gjithë atdheu është në pritje.

BURONJAT E KUÇIT*)

Tarracat përballë dëshmorëve,
vreshta mbi ta,
fshatin që shumë e donin...

Lart,
malet,
ja, aty, sa me dorë majat mund t'i çikësh.

Lexoj:

Aliu nëntëmbëdhjetëvjeçar,
Hitua njëzet e dy,
Lulua tetëmbëdhjetë.
Mbi ta — vija të çrregullta të degëve të rrepeve.

Kur hyn prilli, shkrin borën maleve
dhe mbush rrepet me gjethe dhe këngë bilbilash,
rrepe me rrënjet tek buron një lumë
i ushqyer me gjak.

*) Vend piktoresk në Kuç të Vlorës.

Buronjat e Kuçit, burimi i një lumi,
shtëpitë kuçjote — burime gjaku
për të ardhur agimi.

Rrapua tetëmbëdhjetë,
dy Xhaferët pa mbushur nëntëmbëdhjetë.

Trëndafilja njëzet e tre.
(Maja e trandafiles përbri
përkulur qëndron, mbi të që atëhere.)

Emini katërmëbëdhjetë...
Sa të rinj,
o, sa të rinj shokët tanë plot gjashtëdhjetë!

I bardhë, i bardhë
lapidari i Memos
midis majave të Çikës, Vetëtimës,
dhe horizontit blu matanë maleve, ku shtrihet deti.

Një këngë labe përhapet e përhapet si gurgullimat
e barinjve rreth e qark:
«Nuk mbaj zi, nuk qaj aspak,
se liria i ka këmbët mu në gjak»

ÇDO NJËZET E TETË NËNTOR NË VLORE

Kur ngrihet flamuri çdo njëzet e tetë nëntor në Vlorë,
Ismail Qemali zurret nga busti

te «Sheshi i Flamurit»;
pëllumbat e bardhë fluturojnë nga pishat dhe nga
mjekra e tij;

kur ngrihet flamuri çdo njëzet e tetë nëntor në Vlorë
marinarët zbukurojnë nëndetset dhe torpedinierët
mbi det dhe nën të me flamurë.

Mbi Sazanin, që të kujton shqiponjën që porsa ulet,
u mbështet dielli,
duke i dhënë ngjyrën e flamurit,
detit.

Përplasen dallgët mbi Sazan;
patat e egra të reve fluturojnë mbi të.

MIRĒMĒNGJEZI, ZAHARI

Nuk e di, shok,
por, në radhë tek rrëja për limona,
hyri në dyqan Zaharia me zërin e trashë dhe të çjerrë,
me flokët të zbardhur,
me trupin prej arkave të hepuar
dhe mua m'u duk se hyri, në këtë dyqan, deti.
Dallgët e mëdha.

të renda
të jetës
shkumëzuan dhe u thërmuan në flokët e Zaharisë.
Zaharia prej vitesh më kujtohet:
mbart mbi shpatulla bukë dhe fruta
dhe thërret;

mbi shpinë qëndrojnë kalapeçi, hopa
fëmijët e tij dhe bota.

Ndaj çdo mëngjez

kur në rrugë dëgjohet zëri i tij,
të gjithë e dimë:
dyqanet u furnizuan me qumësht dhe bukë
të ngrohtë.
— Mirëmëngjezi, Zahari!